

SYLLABUSI I KURSIT

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Bazat e shkencave natyrore me metodologji 2
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Gr. 1. E mërkure 09:00-11:15 Salla L5 Gr. 2 E mërkure 12:00-14:15 Salla P2
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Zeqir Veselaj, Asistent: MSc Zenel Krasniqi
Detajet kontaktuese:	Tel. 038 229021 E mail: Zeqir.veselaj@uni-pr.edu ze.krasniqi@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Sipas Kurrikulës Bërthamë 1 brenda fushës kurrikulare Shkencat e Natyrës është koncepti Bota e gjallë. Mësimdhënia dhe të nxëniet mbi botën e gjallë paraqet diversitet të vendeve të zbatimit, strategjive të shumta dhe teknikave specifike. Qëllimi i kursit është që studentët-mësimdhënës të pajisen me njohuri bazë shkencore mbi jetën e gjallë si dhe të zhvillojnë shkathtësi praktike të përdorimit të strategjive, metodave dhe teknikave të mësimdhënies në klasë, laborator dhe natyrë për të arritur rezultatet e të nxëniet për konceptin “Bota e gjallë”. Kursi ndihmon studentët për të arritur kompetencat për mësimdhënien e biologjisë me qasjen nxënësi në qendër dhe si koncept i integruar brenda fushës Shkencat e natyrës në nivelin fillor.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të kursit janë: karakteristikate themelore të jetës, organizimi dhe funksioni nga niveli subqelizor e deri te biosfera si tërësi; hirerarkia e qenieve të gjalla dhe llojllojshmëria e organizmave të gjallë; nevojat e jetës së gjallë për ushqim, energji; karakteristikat morfologjike, anatomike, fiziologjike dhe reproduktive të bimëve, shtazëve dhe mikroorganizmave; ndërtimi dhe funksionet e sistemeve të organeve te njeriu përfshirë shëndetin e tij; marrëdhëniet e organizmave të gjallë me mjedisin e jashtëm dhe me njëri-tjetrin si dhe kërcënimet kryesore sot për botën e gjallë; metodat dhe strategjitë bashkëkohore për studimin e jetës së gjallë.
Rezultatet e pritura:	Në përfundim të këtij kursi, studenti do të jenë në gjendje të: - përshkruaj konceptet kryesore të botës së gjallë në natyrë dhe dalloj karakteristikat kryesore të funksionimit jetës së gjallë përgjatë fazave të zhvillimit evolutiv prej shfaqjes në planet; - identifikoj pesë mbretëritë e organizimit të botës së gjallë sipas shkencës biologjike moderne dhe përshkruaj karakteristikat kryesore të përbashkëta e dalluese përfshirë elementet biogeografike të shtrirjes së tyre; - analizoj dhe interpretoj në nivelin e sistemeve të organeve funksionet bazë të

	<p>jetë së gjallë si: të ushqyerit, riprodhimi, trashëgimia, rritja, zhvillimi, ekskretimi, reagimet, fotosinteza, frymëmarrja, transpiracioni etj.;</p> <p>- hulumtoj elementet e mjedisit jetësor, ndikimin e faktorëve ekologjik për jetën e organizmave dhe vëzhgoj marrëdhëniet e organizmave të gjallë me mjedisin rrethues dhe me njëri tjetrin;</p> <p>- aplikoj strategji e metoda bashkëkohore për mësimdhënien dhe të nxënit për botën e gjallë në klasë, në laborator dhe në natyrë me fokus nxënësin në qendër në shkallët dhe klasët e nivelit fillor.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	13	39
Ushtrime laboratorike	2	15	30
Ushtrime praktike	/	/	/
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në terren	8	2	16
Kollokfiume, seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë/në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	3	9
Portfolio e studentit	1	15	15
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata interaktive me pjesëmarrje aktive të studentëve (pyetje-përgjigje, komente); seminare, projekte individual dhe grupore, konsultime, punë dhe detyra praktike në laborator dhe natyrë.</p> <p>Vizitë studimore ne Parkun e Gërmisë për zbatimin e mësimin praktik në natyrë.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësim formativ, projektet e studentëve, dy teste intermediere, portfolio e studentit, vlerësimi nga praktika dhe testi final. Vlerësimi formativ bëhet përmes këtyre fazave:</p> <p>Vlerësimi i parë intermedier-----15%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermedier-----15%</p> <p>Vlerësimi i punës praktike-----10%</p> <p>Portfolio e studentit-----5%</p> <p>Detyra seminarike individuale/grupore-----5%</p> <p>Testi final----- 50%</p> <p style="text-align: right;">Pikët (%) Nota</p> <p style="text-align: right;">95 -100-----10</p> <p style="text-align: right;">85 – 94----- 9</p> <p style="text-align: right;">75 – 84----- 8</p> <p style="text-align: right;">65 – 74----- 7</p> <p style="text-align: right;">55 – 64----- 6</p> <p style="text-align: right;">Deri 54-----5</p> <p>Sqarim: <i>Vlerësimet intermediere-</i> Vlerësimi i parë intermedier mbahet pas javës së 5 të ligjëratave. Vlerësimi i dytë intermedier mbahet pas javës së 10 të</p>		

	<p>ligjëratave. Nëse studenti humb dy (2) vlerësimet intermediere dhe pjesën praktike e humb të drejtën e hyrjes në provim për vitin akademik përkatës.</p> <p><i>Detyra seminarike</i> në formë projekti dorëzohet në fund të semestrit për vlerësim nga mësimsdhënësit e lëndës.</p> <p><i>Pjesa praktike</i> e provimit është pjesë e vlerësimit final (me pikë) dhe parakusht që studenti t'i nënshtrohet provimit teorik të mësimsdhënësi i lëndës.</p> <p><i>Portfolio e studentit</i>- përfshin materialet e kursit të studentit në dosje: ligjëratat, prezantimet Power Point, fletoren e punës në ligjëratë, fletoren e punës së pjesës praktike, punët seminarike e individuale dhe çdo elemente tjetër të realizuar nga studenti në realizimin e kursit.</p> <p>Pikët nga pjesa formative e vlerësimit (vlerësimet intermediere, projekti dhe praktika) vlejnjë vetëm brenda tri (3) afateve të provimit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>- Veselaj Z.: Biologjia- studimi i jetës, Dispencë me ligjëratat të autorizuara</p> <p>- Paparisto A. 2016 “Metodologjia e mësimsdhënies së Biologjisë” Universiteti i Tiranës, Tiranë</p>
Literatura shtesë:	<p>- Musai B. 2008 “ Mësimsdhënia dhe të nxëniti ndërveprues” Biologji, CDE, Tiranë</p> <p>-Kaskel A. Hummer Jr. P., Lucy D. 1988 “Biology- an everyday experience” Merril Columbus, Ohio</p> <p>Colombo L. Atlas: Zbulu trupin e njeriut (përkthim nga Muci V.), Arba Editions, Tiranë</p> <p>Miho A. Topuzi L., Marka J. 2008 “Botanika e përgjithshme” SHB. Julvin 2, Tiranë</p> <p>Peja N. 2006 “Ekologjia” Shtëpia Botuese P.S.H., 2015, Tiranë</p> <p>Abduli A., Alikaj V. 2010 “Atlas i anatomisë” Albas, Tiranë</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjëratat që do të zhvillohet
Java 1	Biologjia- studimi i jetës E gjalla dhe jo e gjalla. Jeta dhe origjina e saj. Biologjia dhe diciplinat e saj sot. Historiku i zhvillimit të shkencës biologjike në botë.
Java 2	Metodologjia e studimit të qelizës Qeliza- njësi themelore e jetës, evolucioni dhe organizimi i saj. Qeliza bimore dhe shtazore. Riprodhimi i qelizës dhe zhvillimi (mitoza dhe mejoza). Metodatat e modelimit në të nxëniti për qelizën
Java 3	Metodologjia e klasifikimit të botës së gjallë Lënda e studimit të sistematikës dhe taksonomisë së botës së gjallë. Mbretëria Monera (prokariotët): bakteret, algat e gjelbra blu. Virusët. Mbretëria Protista (eukariotët): Protozoat, Protistët bimor (algat). Mbretëria Kërpudhat (Fungi)- mbretëri ne vete. Likenet- organizma dualistik.
Java 4	Metodologjia e studimit të bimëve (Mbretëria Bimore- Plantae) Karakteristikat dalluese nga mbretëritë tjera. Roli dhe funksionii bimëve në ekosistem. Ndarjet kryesore të bimëve. Specializimet ekologjike të bimëve.
Java 5	Metodologjia e studimit të shtazëve (Mbretëria Shtazore- Animalia) Mbretëria shtazore- karakteristikat themelore të shtazëve. Roli dhe funksioni i shtazëve në ekosisteme. Ndarjet kryesore të mbretërisës shtazore .
Java 6	Vlerësimi i parë intermedier

Java 7	Metodologjia e studimit të sistemeve që mbajnë jetën (1) <i>Tretja e ushqimit:</i> marrja, zbërthimi dhe absorbimi i ushqimit. Ushqimi i shëndetshëm dhe kaloritë. Sëmundjet e sistemit të tretjes <i>Shkëmbimi i gazeve.</i> Mushkëritë dhe shkëmbimi i gazeve në organizëm: frymëmarrja dhe frymënxjerrja. Sëmundjet e frymëmarrjes <i>Ekskretimi-</i> veshkët dhe nxjerrja e mbetjeve. Sëmundjet urinare
Java 8	Metodologjia e studimit të sistemeve që mbajnë jetën (2) <i>Qarkullimi i gjakut-</i> zemra dhe enët e gjakut. Gjaku-lëngu i jetës. Limfa dhe sistemi imunitar te njeriu. Sëmundjet e zembrës dhe gjakut dhe sistemit imunitar. <i>Lëvizja-</i> Skeleti dhe nyjet. Muskujt, funksioni dhe llojet e tyre. Sëmundjet dhe dëmtimet e sistemit lokomotor
Java 9	Metodologjia e studimit të sistemeve që kontrollojnë jetën <i>Sistemi nervor-</i> neuroni dhe harku reflektiv. Sistemi nervor qendror dhe periferik. <i>Sistemi endokrin-</i> Gjëndrrat dhe hormonet te njeriu. Cregullimet hormonale <i>Sistemi shqisor (ndijor)-</i> shqisa për shikim, dëgjim, shijim dhe nuhatje.
Java 10	Metodologjia e studimit të sistemeve që vazhdojnë jetën- <i>Sistemi për riprodhim te njeriu.</i> Zhvillimi embrional dhe post-embrional te njeriu. Bartja e karakteristikave trashëguese te njeriu. ADN dhe kromozomet. Gjenet dhe rregullat e themelore të trashëgimisë (puna e Mendelit). Gjenetika humane.
Java 11	Vlerësimi i dytë intermedier
Java 12	Metodologjia e studimit të indeve dhe organeve bimore <i>Indet bimore (histologjia) dhe organet bimore (organografia).</i> Sistemi bimor për përforcim dhe absorbim- rrënja. Sistemi bimor për transport të materieve ushqyese- kërcelli. Sistemi fotosintetik i bimëve- gjethi.
Java 13	Metodologjia e studimit të riprodhimit dhe zhvillimit tek bimët: Riprodhimi aseksual dhe format e tij. Riprodhimi seksual: lulja dhe lulesat, polenizimi, pllenimi, fryti dhe fara.
Java 14	Organizmi i gjallë dhe mjedisi i jashtëm Ekologjia dhe faktorët ekologjik. Nivelet e organizimit ekologjik të qenieve të gjalla. Qarkullimi i materies dhe energjisë në ekosistem. Zinxhirët trofik dhe piramidat ushqyese në ekosistem. Ekosistemi dhe tipet e tyre.
Java 15	Biogjeografia e botës së gjallë Fitogjeografia dhe Zoogjeografia. Shtirja gjeografike e biomeve globale. Faktorët kryesor që përcaktojnë shtrirjen gjeografike të botës së gjallë.

Politikat akademike dhe rregullat:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime është i obliguar. Hyrja me kohë në ligjërata. Pas hyrjes së profesorit në klasë nuk lejohet hyrja dhe pengimi i mësimit. Mungesa në vijimin ligjeratave dhe sjelljet në kundërshtim me etikën akademike do të sanksionohen sipas dispozitave të Statutit të UP-së dhe Rregullores së Studimeve.

Rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular etj.